



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS  
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS  
SPECIJALIZOVANA VEĆA KOSOVA

**Numri:** KSC-BC-2018-01

**Vendosi:** Gjykatësi i vetëm  
Gjykatës Nikola Giju

**Administratore:** Dr. Fidelma Donlon

**Data:** 25 shtator 2020

**Gjuha:** Anglishte

**Klasifikimi:** Rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*

---

**Urdhër në lidhje me dokumente konfidenciale dhe jopublike**

---

**Prokurorit të Specializuar**

Xhek Smith

**T'i dorëzohet**

Përfaqësuesit të Organizatës së Veteranëve të Luftës të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës

**Unë, gjykatësi Nikola Giju, gjykatës i vetëm i Dhomave të Specializuara të Kosovës, i caktuar nga Kryetarja e Dhomave të Specializuara sipas nenit 33(2) të Ligjit nr. 05/L-53 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“Ligji”);**

**Pasi kam marrë “Njoftim të Prokurorisë dhe kërkesë në lidhje me të”, me datë 23 shtator 2020;**

**Duke marrë shënim** se sipas parashtrimeve të Organizatës së Veteranëve të Luftës të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (“OVL-UÇK”), OVL-UÇK-së mund t’i jepen në të ardhmen dokumente jopublike dhe konfidenciale që kanë të bëjnë me punën e Task Forcës Hetimore Speciale (“TFHS”), Zyrës së Prokurorit të Specializuar (“ZPS”) dhe/ose Dhomave të Specializuara;

**Duke marrë parasysh** rreziqet e rënda përkatëse ndaj integritetit të hetimeve të ZPS-së dhe procedimit prej Dhomave të Specializuara si edhe ndaj sigurisë së dëshmitarëve të mundshëm dhe personave të tjerë;

**Në bazë të** neneve 39(3) dhe (11), 53(1), dhe 62(1) të Ligjit;

**Urdhëroj** OVL-UÇK-në dhe cilindo përfaqësues, anëtar ose ndërmjetës të kësaj organizate që:

- (a) të njoftojnë menjëherë ZPS-në nëse aktualisht posedojnë ose nëse në të ardhmen sigurojnë dokumente që duken konfidenciale ose jopublike dhe që kanë të bëjnë me punën e TFHS-së, ZPS-së ose Dhomave të Specializuara;
- dhe (b) të mos incizojnë ose kopjojnë në asnjë formë, ose të mos shpërndajnë me asnjë mjet komunikimi dokumente të tilla ose përmbajtjen e tyre pa autorizimin e ZPS-së ose gjykatësit të vetëm;

**U kujton** OVL-UÇK-së dhe cilitdo përfaqësuesi, anëtari apo ndërmjetësi të saj se në bazë të nenit 53(1) të Ligjit, të gjithë subjektet dhe personat në Kosovë respektojnë pa vonesë të papërligjur çfarëdo urdhri të lëshuar nga Dhomat e Specializuara; dhe

**Paralajmëron** OVL-UÇK-në dhe cilindo përfaqësues anëtar apo ndërmjetës të saj se shkelja e këtij urdhri mund të përbëjë vepër penale sipas Kodit Penal të Kosovës nr. 06/L-074 të vitit 2019.

\_\_\_\_\_  
/nënshkrim/

**Gjykatës Nikola Giju**

**Gjykatës i vetëm**

E premte, 25 shtator 2020

Në Hagë, Holandë.